

Broshurë,  
3-mujori i parë,  
2023




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Janar - Mars 2023



Zhvillimi i qëndrueshëm “është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes, pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t`i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t`i përmbushin nevojat e veta”.






**Banka Kombëtare Tregtare (BKT)** mbështet vazhdimisht projekte në mbrojtje të mjedisit. Në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, stafi i degës së BKT në këtë qytet dhe përfaqësues të bashkisë mbollën pemë në një lulishte të re të krijuar në qendër të qytetit.

### ProCredit Bank

- ▶ ProCredit Group u anëtarësua në Institucionin Financiar Lider (UNEP) për parandalimin e ndotjes nga plastika. Anëtarësimi i mundëson ProCredit Group të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimit të kapaciteteve dhe mbështetjes për të reduktuar ndotjen e mjedisit nga plastika.
- ▶ Banka i dhuroi qytetit të Tiranës 50 pemë, të cilat u mbollën në zonën e Lumit të Tiranës. Kjo zonë ka paraqitur problematika për sa i përket përmytjeve, ndaj shtimi i pemëve do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e këtyre dukurive natyrore negative.
- ▶ Në zyrat e godinës kryesore, banka ka vendosur kosha të ndarë për secilën kategori mbetjeje të organizuar në mënyrë të tillë për të lehtësuar procesin e riciklimit.
- ▶ Pjesë e Panairit dhe Forumit Ndërkombëtar të Energjisë, organizuar në Expocity Albania, ProCredit Bank ishte e pranishme në Forumin "Investimet dhe mbështetja financiare në sektorin e energjisë" me të ftuarin nga njësi mjedisore e ProCredit Bank, Dorian Pashaj. Gjatë forumit përfaqësuesi i bankës prezantoi dhe këshilloi bizneset mbi investimet që banka ofron mbi energjitë e rinovueshme dhe përfitimet që ato kanë.

Të përkushtuar ndaj përgjegjësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, **Raiffeisen** në partneritet me Universitetin





Bujqësor të Tiranës, ka bërë të mundur instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë dhe për krijimin e një përqindjeje mjaftueshmërie në mbulimin me energji të rinovueshme për zonën e Institutit Bujqësor. Falë instalimit të paneleve diellore me 213 kwp fuqi, do të arrihet të kursehet rreth 40% e vlerës së faturës vjetore me anë të prodhimit të tyre energjetike dhe të reduktohet 130 ton emetim i dioksidit të karbonit në atmosferë. Raiffeisen Bank dhe Raiffeisen Invest tregojnë vazhdimisht angazhim në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

**Union Bank** ishte partner silver në Panairin dhe Forumin e Energjisë 2023, organizuar nga Expcity Albania gjatë datave 29-31 mars 2023. Në stendën e Union Bank u ofrua këshillim financiar dhe u prezantuan për vizitorët mundësitë që banka ofron për investimet në panelet fotovoltaike, të cilat ndikojnë direkt në kursimin e energjisë.

Në datën 20 shkurt 2023, në rrugën "Ymer Kurti" në Tiranë u mboll një sasi e konsiderueshme rrënjësh manjole. Nën shprehjen e Carl Sagan "Mburo dhe duaj tokën ku jetojmë, është e vetmja shtëpi që kemi në univers!", **Banka OTP Albania** dha kontributin e saj fizik dhe financiar që qytetit t'i shtohet një tjetër hapësirë e gjelbër.





**Banka Amerikane e Investimeve** mbështeti Unionin Turistik Shqiptar, në organizimin e standës së operatorëve turistikë shqiptarë, për një përfaqësim dinjitoz në Panairin e Turizmit në Berlin ITB 2023. Ky është ndër panairët kryesorë të turizmit dhe një ndër më të mëdhenjtë në botë, me pjesëmarrjen e më shumë se 180 vendeve, 10,000 kompanive ekspozuese, 100,000 përfaqësuesve zyrtarë të kompanive turistike dhe rreth 200,000 vizitorë.

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars, **Credins Bank** nënshkroi Parimet e Fuqizimit të Grave (WEPs). Marrëveshja u firmos nga përfaqësuesit e të dy institucioneve, Z. Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank, dhe Z. Michele Ribotta, përfaqësues i UN Women në Shqipëri, të cilët shkëmbyen ide për të ndjekur strategji specifike në rritjen e qasjes së grave dhe vajzave në shërbimet financiare dhe ato digjitale, në mënyrë që të kenë më shumë mundësi për të mbështetur komunitetin e tyre. 76% e punonjësve të bankës e përbëjnë gratë dhe vajzat, nga të cilat 148 janë në pozicione drejtuese.

### ProCredit Bank

- ▶ Zhvilloi takim të hapur me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, në bashkëpunim me Departamentin e Pedagogjisë dhe Psikologjisë dhe Zyrën e Karrierës, dhe prezantoi programin ndërkombëtar Onboarding, i cili është tashmë një praktikë e përvitshme me qëllim trajnimin, zhvillimin personal dhe profesional si dhe punësimin e të rinjve të sapo diplomuar. Ky program ka si pjesë të tij të integruar trajnime teorike dhe praktike, si dhe zhvillohet në koherencë të plotë me bankat simotra në rajon. Në përfundim të këtij programi secili nga të rinjtë pjesëmarrës ka mundësinë e punësimit.
- ▶ ProCredit në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ofron mundësinë për të investuar në asete fikse që rrisin kapacitetet dhe përmirësojnë kushtet e ofrimit të shërbimit të bizneseve. Qëllimi i ProCredit Bank është të nxisë investimet në fushën e turizmit duke ofruar grant 10% falë bashkëpunimit të saj me BERZH.

Në 6 prill, në kuadër të Panairit të Punës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës organizoi Forumin "30 Vjet Ekonomi të Lirë – Sektori Bankar". **Fibank** ishte pjesë e këtij aktiviteti dhe mbështet vazhdimisht mundësitë për zhvillimin e praktikës për studentët. Shumë prej këtyre studentëve u është ofruar mundësia e punësimit me kohë të plotë dhe sot ata janë punonjës të bankës prej vitesh.





Në kuadër të FemFEST, **Banka Amerikane e Investimeve** mbështeti HARABEL Contemporary në projektin instalacioni "Këpucët e kuqe". Instalacioni prej 600 palë këpucësh u vendos në Sheshin "Nënë Tereza", në nder të grave që nuk jetojnë më si pasojë e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore. "Këpucët e kuqe" është një projekt fillimisht i shfaqur në Meksikë, ideuar dhe krijuar nga arkitektja dhe artistja Elina Chauvet.


**Banka Kombëtare Tregtare (BKT)** mbështeti sërish aktivitetin "Sofra Elbasanase", një aktivitet që hap festimet e Ditës së Verës në Elbasan dhe promovon vlerat artistike, kulturore dhe kulinare të qytetit.

### Credins Bank

- ▶ Në kuadër të përkujdesjes të vazhdueshme për mirëqenien, progresin dhe zhvillimin e institucioneve bashkëpunuese, dhuroi pajisje zyre dhe kompjuterike në përmirësimin e kushteve të punës. Institucionet e mbështetura: *Qendra Shëndetësore Nr.5 Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, Spitali Rajonal Vlorë, Policia Bashkiake Tiranë, K.O.A.SH Mitropolia Korçë, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kavajë (QEZHEF), Kopshti Nr.8 Tiranë, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.*
- ▶ World Marketing Festival - Start Up, është një tjetër aktivitet mbi informimin e risive teknologjike i organizuar me mbështetjen e Bankës Credins.
- ▶ Banka mbështeti disa aktivitetet sportive dhe kulturore, si: projektin muziko-teatral "Më kujtohet" nga artisti Laert Vasili; Ekspozitën me lule të artistes Olsjana Ajdini; Aktivitetin "Taekwondo", ku grup moshë të ndryshme kanë performuar duke dhuruar emocione të forta në artet marciale; dhe Ekipin e basketbollit për femra Partizani, i cili fitoi edhe titullin.
- ▶ Nënshkrimi i kontratës me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, duke qenë kështu mbështetësja kryesore e të gjitha aktiviteteve sportive që do të zhvillohen përgjatë vitit 2023-2024.

### Fibank

- ▶ Në shkurt u organizua një veprimtari me përfshirjen e stafit të bankës, e cila synoi përmirësimin e marrëdhënieve sociale dhe rritjen e kapaciteteve. Gjithashtu, menaxherë biznesi u angazhuan në zhvillimin e trajnimit të stafit të departamenteve të ndryshme për të





përmirësuar më tej efikasitetin e bankës.

- ▶ Mbështeti Ambasadën Bullgare në organizimin e Ditës Kombëtare Bullgare më 3 mars. Pritja e këtij viti u mbajt në Hotel Plaza me shumë të ftuar të shquar duke përfshirë ambasadorët e huaj të akredituar në Shqipëri dhe personalitete të tjera të dalluara nga politika, biznesi dhe arti.
- ▶ Në mbështetje të projekteve kulturore sponsorizoi edicionin e 19-të të Festivalit Ndërkombëtar Vokal të Operës “Marie Kraja” organizuar në Tiranë më 29, 30, 31 Mars.
- ▶ Banka përcjell urimin për kampionin Deni Xhepa i cili triumfoi në Kampionatin Ballkanik të Skive Alpine që u zhvillua në Bullgari. Skiatori kuqezi u shpall kampion i Ballkanit në disiplinën e sllallomit gjigand. Ky kampionat u sponsorizua nga Fibank.
- ▶ Si çdo vit, së bashku me Kryqin e Kuq në Shqipëri, Fibank organizoi një thirrje për dhurim gjaku për stafin e saj dhe të gjithë qytetarët e interesuar.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- ▶ “Puna në një botë në ndryshim” titullohet iniciativa dedikuar punonjësve të rinj të bankës. Qëllimi i këtij trajnimi është të zbulojë se çfarë do të thotë për të rinjtë të punosh në një botë në ndryshim, si dhe çfarë i frymëzon ata më shumë në punën e përditshme. Më datë 19 janar u zhvillua seanca e parë e nismës, e cila u organizua në dy grupe. Grupi i parë përbëhej nga të rinj deri në moshën 30 vjeç nga departamente të ndryshme dhe grupi i dytë përbëhej nga stafi drejtues.
- ▶ Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Lumturisë, 20 mars, Intesa Sanpaolo Bank Albania në bashkëpunim me Grupin Intesa Sanpaolo iu bashkua nismës së “Be Well” për të krijuar një video në lidhje me lumturinë. Kjo video u realizua falë kontributit të fëmijëve të mrekullueshëm të kolegëve të Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale, ku kanë marrë pjesë edhe fëmijë të stafit të bankës në Shqipëri.
- ▶ Intesa Sanpaolo Bank Albania si pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo i kushton vëmendje të veçantë Ditës Botërore të Kursimeve dhe e promovon atë nëpërmjet aktiviteteve të Muzeut të Kursimeve. SAVE ishte një format i krijuar nga Muzeu i Kursimeve dhe Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe synoi të afrojë të rinjtë me temat e qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkulluese, përfshirjes sociale dhe edukimit financiar. Gjatë muajit nëntor, u mbajt një sesion informues nga përfaqësues të Bankës në secilën nga klasat pjesëmarrëse të tre gjimnazeve në Tiranë: “Sami Frasheri”, “Ismail Qemali” dhe “Ernest Koliqi”. Nxënësve iu





kërkua të përzgjedhin një nga sfidat e pazgjidhura në qytetin e tyre në aspektin mjedisor dhe social, si dhe të propozonin alternativa dhe ide për t'i zgjidhur ato me anë të një projekti. Klasa fituese u caktua si "S.A.V.E. Ambassador" dhe përfaqësoi vendin tonë në konkursin ndërkombëtar, i cili u zhvillua online më datë 31 janar 2023. Konkursi "S.A.V.E. Ambassadors" u promovua gjithashtu edhe nga FLITIN - Rrjeti Ndërkombëtar i Edukimit Financiar, krijuar në Divizionin Ndërkombëtar të Bankave Filiale i Grupit Intesa Sanpaolo.

- ▶ Iniciativa "Money Master Challenge", ndërmarrë në kuadër të aktiviteteve të Javës Globale të Parasë, nga **Intesa Sanpaolo Bank Albania** në bashkëpunim me Grupin Intesa Sanpaolo dhe Muzeun e Kursimeve u zhvillua në formën e një kuizi dedikuar për nxënës të moshës 12-13 vjeç. Më datë 13 mars u zhvillua faza kombëtare mes nxënësve të klasës së gjashtë nga 7 paralele të shkollës "Turgut Ozal". Ky kuiz u menaxhua nga stafi i Muzeut të Kursimeve përmes një lidhje online, të cilët mundësuan dhe kodin e lojës. Klasa fituese 6E përfaqësoi Shqipërinë në konkursin ndërkombëtar, ku morën pjesë të gjitha klasat fituese nga vendet ku ka prezencë Grupi Intesa Sanpaolo. Konkursi ndërkombëtar u zhvillua më datë 23 mars, në të njëjtën kohë për të gjitha vendet duke përfshirë rreth 1,500 nxënës. Kjo iniciativë kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve të shkollave 9-vjeçare mbi kulturën bazë financiare dhe ishte një eksperiencë unike për të gjithë pjesëmarrësit.

Grupi i vullnetarizmit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në fund të vitit 2022, organizoi një fushatë për mbledhjen e fondeve në ndihmë të studentëve me pamundësi ekonomike me qëllim mbulimin e shpenzimeve të tarifës shkollore. Klubi ia doli të ndihmonte shumë prej tyre, por nuk mundi të paguante të plotë tarifën e shkollimit për një prej studentëve. Për arsimin, si një prej fushave më në fokus të bankës, **OTP Bank Albania** dha kontributin e saj financiar në shlyerjen e detyrimit të mbetur të këtij studenti.

**ProCredit Bank** mbështeti fondacionin e Sindromës Down Albania, duke investuar në blerjen e 142 pala çorapësh shumëngjyrëshe dhe promovuar ditën e shënuar. Stafi i ProCredit Bank u angazhua të rriste ndërgjegjësimit social për fëmijët e veçantë duke veshur në datë 21 mars çorapet shumë ngjyrëshe dhe publikuar secili foto në profilet personale, për rritje të ndërgjegjësimit online. Fondet e mbledhura nga blerja e çorapeve shumëngjyrëshe, shkojnë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve terapeutike për këta fëmijë







## Java e Parasë

### *Administro paratë e tua, kultivo të ardhmen tënde!*

Shoqata Shqiptare të Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave si dhe bankave anëtare, në datat 20-26 mars 2023, festuan Javën e Parasë 2023.

**Mbi 3,350 nxënës nga 150 shkolla nga i gjithë vendi**

**Mbi 540 studentë nga 9 universitete**

#### **Ceremonia e hapjes së Javës së Parasë 2023**

Ceremonia e çeljes së Javës së Parasë 2023, u organizua në mjediset e Bankës së Shqipërisë, më 20 mars 2023. Aktivitetin e përshëndetën z. Gent Sejko, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë; zj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit dhe Sportit; dhe z. Bledar Shella, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Aktiviteti vijoi me ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit 5 konkurseve të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e Javës së Parasë dhe të shpallura më parë. Këto konkurse u mbështetën nga bankat anëtare të AAB-së.

1. Konkursi "Vizatimit më i mirë", në të cilin u paraqitën për konkurrim më shumë se 350 vizatime nga nxënësit e klasave III-ta prej më shumë se 70 shkollave 9-vjeçare nga e gjithë Shqipëria. Konkursi u mbështet nga Union Bank.
2. Konkursi "Projekti më i mirë", në të cilin nxënësit e 46 klasave të IV- ta nga 38 shkolla të vendit u angazhuan në trajtimin e temës në një projekt fizik ose interpretativ, përmes një videoje të shkurtër. Konkursi u mbështet nga ABI Bank.
3. Konkursi "Fotomontazhi më i mirë", ku 65 nxënës me 61 punime, nga 50 shkolla të vendit, nxënës të klasave të VIII-ta, zbërthyen mesazhin e temës së Javës së Parasë, nëpërmjet imazheve dhe diçiturave. Konkursi u mbështet nga Credins Bank.
4. Konkursi i "Videos më të mirë", në të cilin u paraqitën 69 video, të realizuara nga 97 nxënës të 47 shkollave të mesme të vendit, Konkursi u mbështet nga OTP Bank Albania.
5. Konkursi i esesë më të mirë me temë "Ndryshimet klimatike – përse janë të rëndësishme për sektorin financiar në Shqipëri?" Në këtë konkurrim u paraqitën 10 ese nga 7 universitete të vendit. Fituesit e konkursit, përveç çmimit simbolik të fituar, falë mbështetjes së Bankës Tregtare Kombëtare, do të mund të kryejnë dhe praktikat mësimore pranë kësaj banke.





### Leksione në universitete dhe orë të hapura mësimore

Shoqata Shqiptare e Bankave organizoi disa leksione të hapura dhe orë mësimore, si pjesë e aktiviteteve të edukimit financiar, zhvilluar përgjatë Javës së Parasë.

- Më 15 mars, Irida Huta, Kryetare e Komitetit të Pagesave, Kartave, Digjitalizimit dhe Kanaleve Alternative në AAB, mbajti një orë leksioni të hapur me studentë të Albania University, në degët Financë – Bankë dhe Menaxhim biznesi. Bankingu digjital, efekti në ekonomi i uljes së parasë fizike në qarkullim si dhe mënyra sesi bankat po lëvizin drejt një transformimi digjital të produkteve dhe shërbimeve të tyre, ishin çështjet e trajtuara dhe diskutuara.
- Më 23 mars, Elona Bollano, Kryetare e Komitetit të Riskut dhe Drejtore e Departamentit të Përputhshmërisë së Kapitalit në Bankën Kombëtare Tregtare prezantoi për studentët e nivelit Bachelor, viti i 3-të, dega Financë në Universitetin e Tiranës, temën mbi menaxhimin e rrezikut në banka, sfidat dhe risitë me të cilat po përballet aktualisht sektori bankar.
- Më 24 mars, znj. Xhilda Shehu, Drejtuese për Kanalet Alternative dhe Marketingun Digjital, në Intesa Sanpaolo Bank Albania u gjend pranë studentëve të vitit të 3-të në programin e studimit “Bachelor” në Informatikë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN). Në këtë orë interaktive u fol mbi prirjet në sektorin bankar dhe bankingun e hapur, si trendi i ri global.
- Më 23 mars, u organizua orë mësimore në shkollën “Pandeli Cale”, Korçë, me temë “Administro paratë e tua, kultivo të ardhmen tënde!”, nga Spartak Mele, senior personal banker (Raiffeisen Bank, dega Korçë).





## Kuizi i Parasë 2023

Më 30 mars 2023, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), organizoi për herë të pestë Kuizin Evropian të Parasë, ku u regjistruan 926 nxënës të grup moshës 13-15 vjeç nga 89 shkolla nga i gjithë vendi. Konkursi u realizua online dhe u ndoq me interes të lartë, Livestream në kanalin YouTube të AAB-së nga më tepër se 1,700 shikues. Pjesëmarrësit konkurruan nëpërmjet platformës online Kahoot!, të organizuar në 463 ekipe.

Ekipi fitues i finales kombëtare të Kuizit të Parasë 2023 është nga shkolla 9-vjeçare "Imelda Lambertini" në Elbasan dhe do të konkurrojë duke përfaqësuar Shqipërinë në finalen evropiane të Kuizit të Parasë, e cila do të zhvillohet në Bruksel më 16 maj 2023. Pjesëmarrja në konkursin evropian mundësohet nga Raiffeisen Bank.

